

Qershor 2011

gap

monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

QEVERIA E KOSOVËS



1

Kryeministr



6

Zëvendëskryeministra



19

Ministra




33

Zëvendësministra



162

Këshilltar politik




59

Automjete + Karburantet



218

Telefona mobil + Mbushje



- Edhe këtë muaj Qeveria nuk miratoi Projektligjin për Qeverinë;
- Lejohet importimi i automjeteve të vjetra deri në 13 vite
- Në 6 mujorin e parë Strategjia Legjislative zbatohet vetëm 31%
- Qeveria tejkalon ndarjet buxhetore të parapara me Buxhetin e 2011 për shpenzimet e paparashikuara
- Përzgjidhen edhe pesë sekretar të përhershëm të ministrive

Hyrje

Qeveria e Kosovës ka përmbyllur 6 mujorin e parë të vitit 2011. Aktiviteti i Qeverisë në këtë 6 mujor është i njëjtë me 6 mujorët e tri viteve të mëhershme (shih tabelën më poshtë).

	2008	2009	2010	2011
Vendime	165	145	155	144
Mbledhje	22	21	30	22
Projektligje	59	32	34	45

Edhe pse Qeveria ka miratuar një numër të konsiderueshëm projektligjesh, ajo ende mbetet shumë larg në përbushjen e Strategjisë Legjislative 2011. Për 6 muaj janë miratuar 45 projektligje apo 31.04% e strategjisë. Në mesin e këtyre projektligjeve të miratuara edhe më tutje nuk ndodhet Projektligji për Qeverinë, i cili sipas Strategjisë Legjislative do të duhej të miratohej në qershor 2011. Siç mund të lexoni edhe në brendi të GAP Monitor për muajin qershor, shumica e projektligjeve të miratuara dhe të dërguara në Kuvend nuk përputhen me Planin e Punës së Kuvendit të Kosovës dhe me datat e parapara në Strategji Legjislative.

6 nga 41 vendimet e marra këtë muaj kanë të bëjnë me ndarje të mjeteve buxhetore për projekte të paparashi-

kuara. Në 6 mujorin e parë janë ndarë 3,9 milion euro, apo 1,4 milion euro më shumë se sa që parashihej me fondin rezervë të Qeverisë së Kosovës për 2011.

Në brendi të GAP Monitor për muajin qershor 2011, mund të gjeni raporte më të zgjeruara për vendimin e Qeverisë për akcizat në automjete, përmbytjen e Strategjisë për Shtimin e Njohjeve, Rikonfigurimin e Komitetit Drejtues i Projektit për Asistencë Teknike Energjia nga Linjiti, etj.

Këtë muaj Qeveria e Kosovës ka miratuar 27 dokumente. Listën e plotë të dokumenteve të miratuara dhe dokumentet që i kemi siguruar mund ta shkarkoni nga uebfaqja e GAP Monitor në internet.

Në muajin qershor 2011, Qeveria e Kosovës ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe ka marrë 53 vendime. Vendimet e marra të Qeverisë së Kosovës kanë të bëjnë me:

- 19 vendime për miratim të Projektligjeve;
- 6 vendime për ndarje të mjeteve financiare;
- 5 vendime për emërimin e zyrtarëve në poste të ndryshme;
- 9 vendime për miratim të planeve, raporteve, strategjive;
- 14 vendime tjera;

Përmbajtja

- 1 Edhe këtë muaj Qeveria nuk miratoi Projektligjin për Qeverinë
- 2 Lejohet importimi i automjeteve të vjetra deri në 13 vite
- 3 Qeveria miraton strategjinë për shtimin e njohjeve
- 4 Miratimi i projektligjeve dhe progresi i arritur karshi Strategjisë Legjislative 2011
- 5 Miratohet Projektligji për prokurorimin publik
- 6 Miratohet Projektligji për Transmetuesin Publik

- 7 Përzgjidhen edhe pesë sekretar të përhershëm të ministrive
- 8 Gjatë muajit qershor Qeveria ndanë mbi 2,6 milion euro, tejkalon shumën e parashikuar në Buxhetin 2011
- 9 Rikonfigurohet Komitetit Drejtues i Projektit për Asistencë Teknike Energjia nga Linjiti
- 10 Miratohet Rregullorja për pushimet e shërbyesve civil
- 11 Vendimet tjera

Edhe këtë muaj Qeveria nuk miratoi Projektligjin për Qeverinë

• *Pasi që Kuvendi monitorin punën e Qeverisë, Kuvendi duhet edhe të vërë bazën ligjore për funksionet dhe strukturën e Qeverisë*

• *19 ministritë aktuale janë themeluar dhe funksionojnë në bazë të tri praktikave të ndryshme: 15 janë themeluar me Rregullore të UNMIK 2001/19, dy me ligje të Kuvendit të Kosovës dhe dy me vendime ekzekutive të Qeverisë.*

Sipas Strategjisë Legjislative të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011, Projektligji për Qeverinë do të duhej të miratohej në Qeveri më së largu në Qershor. Mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Në periudhën janar 2008 – qershor 2011, Qeveria e Kosovës ka miratuar dhe proceduar për në Kuvend 252 projektligje. Shumica e këtyre projektligjeve janë shndërruar në ligje pas miratimit në Kuvend. Por, në mesin e këtyre ligjeve nuk ndodhet edhe Ligji për Qeverinë e Kosovës. Edhe pas 39 muajve nga shpallja e pavarësisë dhe nga shndërrimi i Institucioneve të


Përkohshme Vetëqeverisë në Institucione të Republikës së Kosovës, dega e ekzekutivit vazhdon të mos ketë një ligj të veçantë.

Kosova ka sistem parlamentar të qeverisjes. Anëtarët e Kuvendit zgjidhen drejtpërdrejt nga populli, kurse Qeveria zgjidhet nga Kuvendi dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Pasi që Kuvendi monitorin punën e Qeverisë, Kuvendi duhet edhe të vërë bazën ligjore për funksionet dhe strukturën e Qeverisë. Struktura dhe funksionet e degës së ekzekutivit kanë qenë të rregulluara me

Rregulloren e UNMIK 2001/19. Në bazë të kësaj rregulloreje, e cila ka pasur statusin e ligjit, janë themeluar dhe kanë funksionuar 15 ministri. Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, pas 15 qershorit 2008 Qeveria nuk i është referuar më rregullores së UNMIK-ut. Por as nuk ka dërguar në Kuvend ligj të ri për të zëvendësuar këtë rregullore. Rregullorja e UNMIK është zëvendësuar me akte nënligjore të cilat janë miratuar nga Qeveria. Kosova tani ka 19 ministri, 15 prej të cilave janë themeluar në bazë të rregullores të UNMIK, 2 me ligje

Portofolet ministrore 2001-2011

—●— Ministritë —■— Zëvendëskryeministrit —▲— Zëvendësministrit



të Kuvendit të Kosovës dhe 2 me vendime të Qeverisë. Andaj, nevojitet ekzistimi i një baze të qartë ligjore e cila themelon dhe shuan postet ministrore.

Në muajin qershor Qeveria ka marrë dy vendime që kanë të bëjnë me strukturën qeveritare dhe me koston e Qeverisë. Me vendimin 07/19 të datës 8 qershor 2011, Qeveria e Kosovës ka plotësuar Rregulloren Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të ZKM-së dhe ministrive duke shtuar edhe Ministrinë e Diasporës, e cila u krijua pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Si dhe në mbledhjen e 15 qershorit me vendimin 12/19 Qeveria obligoi Ministrinë e Financave që të krijoj një linjë të veçantë

buxhetore për Ministrinë e Diasporës dhe i ndau nga rezervat e Qeverisë 750 mijë euro për funksionimin e kësaj ministrie për vitin 2011.

Ndryshimet në strukturën qeveritare kanë edhe ndikim financiar, andaj së bashku me Ligjin për Qeverinë duhet të hartohet edhe Vlerësimi i Ndikimit Financiar. Deri më tani Qeveria nuk është treguar transparente në bërjen publike të të dhënave për pagat e zyrtarëve të lartë publik, shpenzimet e tyre të komunikimit, transportit, reprezentacionit, etj.

Instituti GAP ka hartuar një analizë të veçantë e cila argumenton nevojën për miratimin e Ligjit për Qeverinë. Kjo analizë mund të lexohet në uebfaqen e Institutit GAP (www.institutigap.org) apo në portalin e GAP Monitor në internet (www.gapmonitor.org)

Duke u bazuar në të dhënat për pagat e zyrtarëve të lartë publik të paraqitura në Agjencionin Kundër Korrupsion (AKK) dhe duke u bazuar në udhëzimet administrative për shpenzimet qeveritare, Instituti GAP ka bërë një përlllogaritje të përafërt për ndikimin financiar të funksionit të strukturës aktuale qeveritare.

Kostoja e Qeverisë së Kosovës				
Paga (sipas deklarimeve në AKK, pagës mesatare dhe pagës minimale)				
	1	2	3	4
	Nr. i pozitave	Niveli i pagës mujore për pozitë (€)	Niveli i pagës vjetore për pozitë (€)	Totali vjetor (Niveli i pagës shumëzuar me numrin e pozitave)
Kryeministri	1	1.661	19.932	19.932
Zv/kryeministri	6	1.357	16.284	97.704
Ministri	16*	1.270,5	15.246	243.936
Zv/ministri	33	1.182,5	14.190	468.270
Këshilltari politik	162	693	8.316	1.347.192
Nëpunës në kabinet	184	345	4.140	761.760
Shofer	59	170	2.040	59.160
Nëntotali për paga (vjetore)				€ 2.997.954
Nr. total i automjeteve për të gjitha pozitat e larta ekzekutive:				59
Komunikim (sipas Udhëzimit Administrativ 04/2008)				
	Njësi	Mobil (€ për muaj)		Totali vjetore (Mobil+Fiks*12 muaj*nr.i posteve)
		Roming	Mbushje	
Kryeministri	1	Pa kufi	-	Pa kufi
Zv/kryeministri	6	250	-	200
Ministri	16	250	-	150
Zv/ministri	33	150	-	100
Këshilltari politik	162	-	70	50
Shefi i kabinetit të Kryeministrit	1	150	-	100
Nëntotali për komunikim:				€ 444.480
Nr. i aparate telefonike (mobil):				218
Reprezentacion (sipas Udhëzimit Administrativ 01/2008)				
	Nr. i pozitave	€ në muaj	€ në vit	Totali (Shpenzimet vjetore * nr. i pozitave)
Kryeministri	1	Pa kufizim	Pa kufizim	Pa kufizim
Zv/kryeministri	6	Pa kufizim	Pa kufizim	Pa kufizim
Ministri	19**	500	6000	114.000
Zv/ministri	33	200	2400	79.200
Këshilltari politik	162	100	1200	194.400
Nëntotali për reprezentacion (pa llogaritur kryeministrin dhe zëvendëskryeministrat):			€ 387.600	
Totali (paga+komunikim+reprezentacion)				€ 3.830.034

*Për faktin se tre nga ministrat janë njëkohësisht edhe ministra, ata i kemi llogaritur vetëm për njërin post.

** Për dallim nga rastet e mësipërme kur kemi përlogaritur vetëm 16 ministra, për shkak se tre nga ministrat ushtrojnë edhe rolin e zëvendëskryeministrit, tek shpenzimet e reprezentacionit kemi llogaritur 19 ministrat, për shkak se zëvendëskryeministrat e kanë të pa limituar buxhetin për reprezentacion.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të shpenzimeve buxhetore të Qeverisë së Kosovës për këto kategori, Kuvendi i Kosovës duhet t'i kërkojë Qeverisë që së bashku me draftin për Ligjin për Qeverinë, t'i bashkëngjis edhe këto dokumente:

- Nivelin e pagave për të gjithë zyrtarët e lartë publik në institucionet e Qeverisë së Kosovës;
- Raportin Mjor për Shpenzimet e Telefonave apo komunikimit të cilat hartohen nga Departamenti i Teknologjisë Informative (DTI), ashtu siç parashihet me nenin 11 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2008 për përdorimin e telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e Kosovës;
- Raportin e shpenzimeve për përdorimin e automjeteve zyrtare i cili hartohet nga Njësia për Monitori-

min e Përdorimit të Automjeteve, e cila funksionin në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, ashtu siç parashihet me nenin 13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2008 për përdorimin e automjeteve zyrtare;

- Baza e të dhënave të të gjitha automjeteve, të cilën e posedon Njësia për Monitorimin e Përdorimit të Automjeteve, ashtu siç parashihet me nenin 14 të UA Nr. 03/2008;
- Të dhënat e detajuara për Kodin e Veçantë Ekonomik për Shpenzimet e Reprezentacionit, ashtu siç parashihet me nenin 11.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2008 për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit për zyrtarët e institucioneve të Qeverisë së Kosovës.

Përkundër kërkesave tona të drejtuara ndaj institucioneve kompetente, ashtu siç parashihet edhe me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, nuk na është lejuar qasje në dokumentet e listuara më sipër. Andaj, Kuvendi i Kosovës duhet ta obligojë Qeverinë për publikimin e këtyre raporteve.

Instituti për Studime të Avancuara GAP ka hartuar një analizë të veçantë me të cilën argumentohet nevoja për ekzistimin i një Ligji për Qeverinë, duke dhënë edhe rekomandime konkrete për përmbytjen e tij. Kjo analizë mund të lexohet në uebfaqen e Institutit GAP (www.institutigap.org) apo në portalin e GAP Monitor në internet (www.gapmonitor.org).

Lejohet importimi i automjeteve të vjetra deri në 13 vjet

• *Deri në fund të vitit 2010 në Kosovë, sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ishin në qarkullim 400,488 automjete. Nëse e krahasojmë këtë numër të automjeteve në qarkullim me statistikat e fundit të regjistrimit të popullsisë i bie një automjet për çdo të katërtin banorë të Kosovës.*

• *Vendimi i ri i Qeverisë pritet që të rrit edhe më tutje numrin e automjet në qarkullim në Kosovë.*

Në mbledhjen e 20 të mbajtur më 22 qershor 2006 Qeveria e Kosovës ka marrë dy vendime për importimin e automjeteve: me vendimin 05/20 vendosi normën e re të tatimit të akcizës për veturat e importuara, kurse me vendimin 06/20 u ndalua importimi i të gjitha veturave më të vjetra se 13 vite.

Me këto dy vendime u bë plotësimi i Aneksit A të Ligjit Nr. 03/L-220 për normën e tatimit të akcizës në Kosovë. Ligji i lë hapur mundësinë që Qeveria të ndryshojë normën e akcizës për çdo produkt, pas konsultimit paraprak me Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa. Kjo praktikë e ndryshim-plotësimit të ligjit nuk haset në ligjet tjera të aprovuara deri më tani nga Kuvendi i Kosovës. Brenda dy muajve, ky është vendimi i dytë që rrit akcizat në produkte, pas vendimit të muajit prill për vendosjen e tatimit të akcizës në lojërat e fatit.

Para marrjes së vendimit në nivel të Qeverisë, më 15 qershor 2011 Ministri i Financave kërkoi nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa që të aprovojë propozimin për normat e reja të

akcizës dhe zgjatjen e vjetërsisë së automjeteve të importuara nga 8 në 13 vite. Sipas Ministrit eksistojnë katër arsye për marrjen e një veprimi të tillë, e që mund të ndahen në arsyet sociale, buxhetore, të sigurisë dhe ambientale:

- **Aspekti social** i këtij vendimi, sipas Ministrit, është se do iu mundësohet edhe kategorive më të varfra të posedojnë një automjet, ngase automjeti është pjesë e nevojave të përditshme personale;

- **Rëndësia buxhetore** e këtij vendimi është se pritet që Buxheti i Kosovës të inkasojë 20 milion euro shtesë në vit;

- **Vendimi i ri** për importin e veturave sipas ministrit do të rris sigurinë në trafik, për shkak se do të eliminohen veturat më të vjetra dhe të pasigurta, ngase veturat që do të sillen nga jashtë do të jenë në gjendje më të mirë teknike; si dhe

- **Ambienti** do të jetë më i pastër për të njëjtat arsye sikurse ato të sigurisë, për shkak se veturat që janë në qarkullim brena territorit të Kosovës janë potencialisht më ndotëse se sa ato që do të importohen.

Një nga arsyet tjera ishte se kjo zgjatje e vjetërsisë së importimit

të automjeteve po bëhet pasi që janë stabilizuar kontrollet teknike dhe qendra e homologimit. Anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa e miratuan me shumicë votash këtë propozim të Ministrit.

Anëtarët e Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa miratuan propozimin e Ministrit edhe pse arsyetimi i paraqitur nga ai nuk ishte i bazuar në fakte shtesë dhe ishte kundërthënës. Kundërthënës për këto arsye:

- Rritja e viteve për importimin e automjeteve shoqërohet edhe me ngritje të akcizës dhe si rrjedhojë kategoritë e varfra nuk do të kenë mundësi të pajisen me automjete për shkak të çmimeve të larta të akcizës;

- Rritja e sigurisë në trafik mund të bëhet vetëm me funksionimin më të mirë të qendrave të kontrollit të automjeteve dhe atyre të homologimit. Në rast se nuk merren masa për përmirësimin e kontrolleve dhe homologimit, importi i veturave më të vjetra vetëm do të rris pasigurinë në trafik.

- Si dhe, ambienti mund të përmirësohet vetëm me vënien e kontrollit më të rreptë në aspektet teknike të automjeteve dhe cilësinë e karburanteve. Importi-

mi i veturave më të vjetra, pa marrjen e masave tjera për kontrollin teknik dhe cilësinë e karburanteve, vetëm do të ndot ambientin dhe do të shtojë edhe më shumë vendet për grumbullimin e hekurishteve.

Sipas vendimit 05/20 të Qeverisë së Kosovës, veturat e reja të

importuara do të lirohen nga tatiimi i akcizës. Kurse për veturat e amortizuara do të aplikohen normat e akcizës si më poshtë:

Ky vendim i Qeverisë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit (28 qershor 2011). Deri në fund të vitit 2010 në Kosovë, sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ishin në qarkullim 400,488

automjete. Nëse e krahasojmë këtë numër të automjeteve në qarkullim me statistikat e fundit të regjistrimit të popullsisë i bie një automjet për çdo të katërtin banorë të Kosovës. Vendimi i ri i Qeverisë pritet që të rrit edhe më tutje numrin e automjet në qarkullim në Kosovë.

Viti	≤ 2000 ccm	2001 ccm deri 3000 ccm	≥ 3000
Të reja	0		
≤ 8	500 €	500 €	1000 €
≤ 9	700 €	700 €	1500 €
≤ 10	800 €	900 €	1800 €
≤ 11	900 €	1100 €	2100 €
≤ 12	1000 €	1300 €	2400 €
≤ 13	1100 €	1500 €	2700 €





Qeveria miraton strategjinë për shtimin e njohjeve

• *Ky dokument, krahas prezantimit të problemit dhe procesit të përgjithshëm të njohjes së pavarësisë së Kosovës, përmban edhe pjesën tjetër operacionale dhe Planin e Veprimit për shtimin e njohjeve.*

Me 2 mars të këtij viti, Qeveria morri vendim të iniciojë hartimin e agjendës lobuese për shtimin e njohjeve për Republikën e Kosovës. Por, vetëm në mbledhjen e 8 qershorit Qeveria miratoi Strategjinë për Përmbylljen e Procesit të Njohjeve për Republikën e Kosovës. Pra Qeverisë iu deshën më shumë se 3 muaj për të hartuar këtë strategji për njohje! Kjo strategji mëton që të angazhojë, përsos energji institucionale, edhe faktorë të tjerë si pjesëtarë të shoqërisë civile dhe personalitete të njohura botërore që kanë ndikim tek shtetet tjera për të lobuar.

Në këtë dokument po ashtu janë identifikuar edhe pengesat kryesore në procesin e njohjeve sikurse:

- Kundërshtimi nga ana e Federatës Ruse të Planit të Ahtisaarit në Këshillin e Sigurisë të Kombeve të Bashkuara;
- Mosarritja e konsensusit e të gjitha vendeve anëtare të BE-së për ta njohur Kosovën, ku si rrjedhojë është krijuar përshtypja se Kosova ende është një çështje e pazgjidhur europiane;
- Gjykimi i gabuar i disa shteteve që përballen me sfida të brendshme politike, që shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte një hap secesionist (shkëputje nga një shtet sovran) dhe jo një veprim që erdhi si pasojë e dhunës dhe shpërbërjes jo-konsensuale të një shteti federal multinacional, gjë të cilën qarqet diplomatike serbe po e shfrytëzojnë duke shtuar frikën tek vendet që ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, duke u thënë se mund të krijojnë tendencave secesioniste brenda territoreve të tyre;
- Përparësia e ulët që i vihet njohjes dhe mungesa e interesit të menjëhershëm nga një numër i madh i

shteteve;

- Vënia e Kosovës më poshtë në prioritetet e politikës së jashtme të vendeve të fuqishme përkrahëse të konsolidimit të shtetësisë së Kosovës;
- Largimi i shumë personaliteteve me ndikim nga skena ndërkombëtare përgjatë procesit të çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës.

Ky dokument, krahas paraqitjes së problematikës dhe procesit të përgjithshëm të njohjes së subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, përmban edhe pjesën tjetër operacionale dhe Planin e Veprimit të cilat na është thënë se nuk mund të bëhen publike për arsyeje të ndjeshmërisë së procesit.

Megjithatë, në këtë dokument janë përshkruar shumë shkurtime disa pika të planit të veprimit ku vlen të theksohet koordinimi dhe restrukturimi institucional. Si pjesë e strukturës për lobim, parashihet të krijohen një Task-Forcë, Grupi Avokues dhe Ekipi i Logjistikës. Task-Forca për lobim do të bashkë-kryesohet nga Zëvendëskryeministri për Njohje dhe Ministri i Punëve të Jashtme si dhe do të përfshijë përfaqësues të institucioneve të politikës së jashtme. Kjo task-forcë do të ketë po ashtu për detyrë të mbikëqyrë zbatimin e kësaj strategjie si dhe të këshilloj Grupin Avokues në përmbushjen e aktiviteteve relevante për zbatimin e saj.

Po ashtu, në këtë strategji janë paraqitur edhe tri drejtime strategjike të cilat duhet të ndiqen nga zbatuesit e këtij dokumenti: Shtetet individuale; Grup-shtetet specifike dhe rajonet; Organizatat ndërkombëtare dhe mekanizmat.

Në këtë dokument janë paraqitur

edhe argumentet e përgjithshme se pse duhet të njihet Kosova nga shtetet që ende nuk e kanë ndërmarrë një hap të tillë:

- Kosova është njëra nga shtat shtetet e pavarura që u krijuan si pasojë e shpërbërjes së dhunshme dhe jo-konsensuale të ish Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë. Kosova ka qenë pjesë konstituive e shtetit federativ e cila më nuk ekziston si subjekt i ligjit ndërkombëtar.

• Politika shtet-ndërtuese e Kosovës përgjatë viteve të 90' ishe e bazuar në rezistencë politike me mënyra paqësore, duke mos përjashtuar persekutimin e vazhdueshëm dhe represionin, si dhe politikën luftë-nxitëse të Serbisë. Kosova është i vetmi shtet evropian që ka dy fitues të çmimit prestigjioz Sakharov të Parlamentit Evropian, dy ikona të rezistencës paqësore dhe disidentë politik: Ibrahim Rugova dhe Adem Demaçi.

• Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, duke iu përgjigjur kërkesës së bërë nga Serbia përmes Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, nëse Deklarata për shpalljen e pavarësisë së Kosovës ishte në linjë me ligjin ndërkombëtar, e dha opinionin e saj rreth kësaj kërkeje me 22 korrik 2010, me të cilin konfirmoi që shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur ndonjë ligj të aplikueshëm ndërkombëtar. Ky opinion, edhe një herë konfirmoi që Kosova është rast sui generis, bazuar po ashtu në faktin që shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka shkaktuar ndonjë efekt zinxhirë negativ.

Kosova shpalli pavarësinë e saj me 17 shkurt 2008. Vendet më të fuqishme demokratike si SHBA, Japonia, Kanadaja, dhe 22 vendet të BE-së kanë njohur deri më tani Kosovën. Numri i njohjeve ka arritur shifrën 76.



Miratimi i Projektligjeve dhe progresi i arritur karshi Strategjisë Legjislative 2011

• *Aprovohet kërkesa e MPJ-së për angazhimin e zyrtarëve për pajisje me dokumente personale nëpër misionet konsullore të Republikës së Kosovës.*

- Në muajin qershor, Qeveria e Kosovës ka miratuar 19 projektligje nga SL'11. Projektligjet e miratuara janë:
1. Projektligjin për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë;
 2. Projektligjin për Markat Tregtare;
 3. Projektligjin për Dizajnin Industrial;
 4. Projektligjin për Patenta;
 5. Projektligjin për Arsimin Para- universitar;
 6. Projektligji për Përgjegjësin Penale të Personave Juridik;
 7. Projektligji për Bashkëpunim Ndërkombëtarë në Çështjet Penale;
 8. Projektligji për Dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjen cinë Kosovare të Privatizimit;
 9. Projektligji për Riorganizimin e Ndërmarrjeve dhe Pasurisë;
 10. Projektligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
 11. Projektligji për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës.
 12. Projektligji për Arsimin e Lartë
 13. Projektligji për Prokurim Publik
 14. Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave
 15. Projektligji për Transmetuesin Publik të Kosovës
 16. Projektligji për Përfitim të ish Zyrtarëve të lartë
 17. Projektligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësime të Konformitetit
 18. Projektligji për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit
 19. Projektligji për Rregullimin e Tokës

Nëntëmbëdhjetë projektligjet e miratuara gjatë muajit qershor, ngritin në 45 numrin e projektligjeve të miratuara apo 31.04% të SL'11. Deri në fund të vitet kanë mbetur për tu miratuar edhe 102 projektligje apo 68.06% e strategjisë.

Strategjia Legjislative 2011		
148 projektligje		
Janar-Maj 26 +	Qershor 19	Për tu miratuar edhe: 103
31.04%	68.06%	

Gjashtë nga Projektligjet e lartpërmendura i janë kthyer Qeverisë për ri-miratim, projektligje të cilat kanë mbetur në procedurë nga mandati i kaluar ku pas shpërbërjes së Kuvendit, projektligjet është dashur të miratohen përsëri në ekzekutiv dhe më pas të procedohen edhe një herë në Kuvend.

Tabela më poshtë pasqyron 19 projektligjet e miratuara në qershor, datat e miratimit të tyre në Qeveri, afatet kohore të parapara me SL'11 dhe afatet kohore të parapara me Planin e Punës së Kuvendit të Kosovës për 2011.

Projektligji	Dërgimi në ZSHNJ ashtu siç parashi-het me SL'11	Miratimi në Qeveri	Plani i Punës së Kuvendit të Kosovës 2011	
			Leximi i I	Leximi i II
Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë	31.5.2011	1.6.2011	07/2011	09/2011
Markat Tregtare	31.5.2011	1.6.2011	07/2011	09/ 2011
Dizajnin Industrial	30.5.2011	1.6.2011	07/2011	09/2011
Patenta	31.5.2011	1.6.2011	07/2011	09/2011
Arsimin Parauniversitar	31.5.2011	8.6.2011	07/2011	09/2011
Përgjegjësin Penale të Personave Juridik	31.5.2011	8.6.2011	07/2011	09/2011
Bashkëpunim Ndërkombëtarë në Çështjet Penale	30.4.2011	8.6.2011	05/2011	07/2011
Dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit	30.4.2011	15.6.2011	05/2011	07/ 2011
Riorganizimin e Ndërmarrjeve dhe Pasurisë	1.04.2011	15.6.2011	04/ 2011	06/2011
Agjencinë Kosovare të Privatizimit	30.4.2011	15.6.2011	05/2011	07/ 2011
Arsimin e Lartë	31.5.2011	22.6.2011	07/2011	09/2011
Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës	30.4.2011	22.6.2011	05/2011	07/2011
Prokurim Publik	31.5.2011	29.6.2011	07/2011	09/2011
Komisioni i Pavarur i Mediave	31.5.2011	29.6.2011	07/2011	09/2011
Transmetuesin Publik të Kosovës	31.5.2011	29.6.2011	07/2011	09/2011
Përfitimin e ish Zyrtarëve të lartë	30.4.2011	29.6.2011	05/2011	07/2011
Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësime të Konformitetit	31.5.2011	29.6.2011	07/2011	09/2011
Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit	31.3.2011	29.6.2011	4/2011	6/2011
Rregullimin e Tokës	31.3.2011	29.6.2011	4/2011	6/2011

Dy nga projektligjet më të rëndësishme, të cilat janë kërkuar edhe me raportet e progresit të Komisionit Evropian, janë Projektligji për Prokurorimin Publik dhe Projektligji për Transmetuesin Publik, të cilat do ti përshkruajmë më detajisht në këtë numër të GAP Monitor.

Miratohet Projektligji për prokurim publik

• Në mbledhjen e saj të radhës, të mbajtur më 29 qershor, Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Prokurim Publik.

Qëllimi i këtij Projektligji është që të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik dhe nëpunësve civil dhe të personave të tjerë që kryejnë aktivitete të prokurimit publik, duke kërkuar që vendimet e individëve të tillë të kenë baza ligjore dhe faktike për vendimet që i marrin, që të mos ndikohen nga interesat personale dhe të karakterizohen me jodiskriminim dhe me një shkallë të transparencës përballë qytetarëve të Kosovës. Po ashtu qëllim tjetër i këtij projektligji është që të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar duke mbrojtur interesat e Republikës së Kosovës, po ashtu edhe paanshmërinë në punë dhe etikën e personave zyrtarë që përfshihen në këto aktivitete.

Sipas këtij projektligji, çdo kontratë më e madhe se 10 mijë euro duhet të nënshkruhet nga vetë

ministri. Arsyeja për futjen e kësaj norme sipas Qeverisë është kërkesa e Bashkimit Evropian, për ta bërë procesin e shfrytëzimit të fondeve publike më transparentë dhe më të përgjegjshëm. Megjithatë, janë zyrtarët e prokurimit ata të cilët do të merren me procedura, por do të jetë ministri ai që në fund do të nënshkruaj kontratat e mesme dhe të mëdha.

Kjo nuk është hera e parë që Qeveria tenton ta fus në rregull të tillë. Në maj të vitin të kaluar Qeveria kishte miratuar një Udhëzues Administrativ për Nënshkrimin e Kontratave Publik me Vlerë të Mesme dhe të Lartë, që parashihte se kontratat mbi 10 mijë euro të nënshkruhen edhe nga sekretari dhe vetë ministri. Një vendim i tillë u kritikua nga shoqëria civile sepse nuk ishte në përputhje me ligjin. Në qershor 2010 Qeveria kishte miratuar

Projektligjin për Prokurim Publik i cili përmbante edhe kërkesat e këtij Udhëzimi Administrativ. Por, deputetët nuk e kishin kaluar ligjin ashtu siç dëshironte Qeveria.

Shoqëria civile vazhdimisht kishte qenë kundër një qasjeje të tillë sepse kësaj politike ka më shumë hapësirë për tu përzier në çështjet e tenderëve, sepse nëpunësit civil që kanë përgjegjësinë për të bërë përzgjedhjen e operatorëve ekonomik në procese prokurimi do të nënshtrohen presioneve publike. Kjo është shumë e rrezikshme sidomos kur dyshohet se burimi më i madh i korrupsionit janë pikërisht tenderët. Pastaj, një rregull i tillë do të vononte edhe më shumë procedurën tenderuese.

Miratohet Projektligji për Transmetuesin Publik

Në po të njëjtën mbledhje, më 29 qershor, Qeveria ka miratuar edhe projektligjin për Transmetuesin Publik të Kosovës. Sipas këtij projektligji radio Televizioni i Kosovës (RTK), duke filluar nga viti 2012 do të ketë buxhet sa 0.7% e të hyrave totale të buxhetit të Kosovës, duke i zbritur të hyrat vetjake të nivelit qendror dhe lokal, të hyrat e dedikuara dhe të hyrat e njehershme. Bazuar në të hyrat e tanishme të buxhetit të Kosovës kjo i bie se buxheti i RTK-së do të jetë rreth 9 milion euro në vit.

Transmetuesi Publik i Kosovës ka një kohë që nuk e ka të definuar si duhet mënyrën e financimit, që kur Gjykata Kushtetuese më 16 tetor 2009 kishte marrë vendim që të pezullojë mënyrën e financimit

të RTK-së nga qytetarët përmes pagesës prej 3.5 euro që bëhej bashkë me faturën elektrike.

Taksa publike për RTK është mbledhur nga KEK që nga fundi i vitit 2003, për të cilën KEK ka qenë i vetmi agent i vjeljes së taksës, dhe si i tillë paraqiste barrë të madhe për KEK-un në mënyrë që të përmirësohen të hyrat e saja. Arkëtimi i mjeteve të RTK-së bëhej përmes KEK-ut ku çdo familje, biznes apo institucion tjetër i Kosovës i cili shfrytëzonte shërbimet elektrike të KEK-ut ngarkohej me një shumë prej 3.5 euro për çdo muaj. Për këtë shërbim KEK-ut i paguhej provizioni në lartësi prej 6% dhe reklamimi gratis në RTK për vetëdijesimin e qytetarëve Kosovar për siguri,

pagim dhe kursimin e rrymës. Me nxjerrjen e Ligjit nr.02/L 47 për Radiotelevizionin e Kosovës, në janar të vitit 2006, ku përveç që përgjegjësia raportuese për shpenzimet financiare të RTK-së kaloj nga përgjegjësia para PSSP-së në përgjegjësin ndaj Kuvendit të Kosovës, gjithashtu u liruan nga pagesa familjet të cilat marrin asistencë sociale si dhe ato pjesë të territorit të ku nuk ka shtrirje rrjeti RTK. Bordi i KEK në gusht të 2007 morri vendim që kontrata mes RTK dhe KEK të shkëputet duke arsyetuar këtë me humbjet që po i shkakton kjo kontratë inkasimit të llogarive të papaguara të energjisë elektrike. Që nga 2010, RTK paguhet direkt nga Buxheti i Kosovës.



Përzgjidhen edhe pesë sekretarë të përgjithshëm të pesë ministrive

- Gjatë muajit qershor Qeveria ka bërë përzgjedhjen e pesë sekretarëve të përgjithshëm të Ministrive të ndryshme.
- Ministria e Administratës Publike nuk ka pranuar të bëjë publike përbërjen e komisioneve për përzgjedhjen e sekretarëve të përgjithshëm në tri ministri: MF, MTI dhe MFSK.
- Janë shpallur edhe katër pozita të reja për postin e sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e 18 dhe 20, ka emëruar edhe pesë sekretarë permanent në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe në Ministrinë e Forcës së Sigurisë.

Përzgjedhja e sekretarëve të përgjithshëm të MEZH, MASHT dhe MF u bë në bazë të konkursit të shpallur më 1 prill 2011, i cili ishte i hapur për 15 ditë. Pozita e sekretarit të përgjithshëm ushtrohet për një periudhë 3 vjeçare me pagë mujore 693 euro.

Në postin e Sekretarit të Përgjithshëm të MZHE është emëruar Nazmi Zene-laj ish kryetar i Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjen Hidro-ekonomike "Ibër Leepenc". Gjersa në postin e Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT është përzgjedhur Xhavit Dakaj ish udhëheqës i personelit në Komunën e Lipjanit.

Komisioni për Vlerësimin e Kriteve

bazuar në rregulloren për emërimet në pozitën e larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës përbëhet nga: tre sekretarë të përgjithshëm; një profesor fakulteti nga lëmi përkatëse; dhe një anëtar nga shoqëria civile.

Komisionin Vlerësues për përzgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të MZHE është përbërë nga këta anëtar: Eshref Shabani (kryesues), Arben Çitaku (anëtar), Zana Kotori (anëtare), Skender Ahmeti (ligjërues në UP) dhe Berat Rukiqi (Oda Ekonomike e Kosovës).

Kurse, Komisioni Vlerësues për përzgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT është përbërë nga këta anëtar: Fitim Sadiku (kryesues), Shkelzen Sylja (anëtar), Arben Çitaku (anëtar), Basri Çapriqi (ligjërues në UP) dhe Afërdita Maliqi (OJQ).

Ndërsa përzgjedhja e sekretarëve të përgjithshëm të MF, MTI dhe MFSK u

bë në bazë të konkursit të dytë të shpallur nga Qeveria e Kosovës, pozitë e cila poashtu ushtrohet për një periudhë 3 vjeçare me pagë mujore 909.90 euro për dallim nga konkursi i parë ku për të njëjtën pozita paga figuronte 693 euro.

Në postin e sekretarit të përgjithshëm në MF u emërua Naim Baftiu, ish drejtor i Departamentit të Administratës Qendrore në Ministri të Ekonomisë dhe Financave. Ndërsa në postin e sekretarit të përgjithshëm në MTI u emërua Eliana Naka. Dhe në MFSK u emërua Shkelzen Sylja i cili edhe ishte U.d në po të njëjtën pozitë.

Qeveria ka shpallur edhe katër pozita të tjera për plotësimin e pozitave të sekretarëve të përgjithshëm edhe në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme me pagë mujore bruto 900.90 euro.

Gjatë muajit qershor Qeveria ndanë mbi 2,6 milion euro nga shpenzimet e paparashikuara

• *Fondi i Qeverisë për Rezervat e paparashikuara është 2,5 milion euro*

• *2.6 milion eurot e ndara në qershor, së bashku me 1.3 milion eurot e ndara në pesë mujorin e parë, bëjnë që në pjesën e parë të 2011 Qeveria të shpenzojë më shumë mjete nga rezervat e paparashikuara, se sa që janë destinuar fillimisht me Buxhetin e Kosovës 2011*

Në mbledhjen e 17-të të Qeverisë, të mbajtur më 1 qershor 2011, është marrë vendimi për ndarjen e shumës prej 330 mijë euro për kompensimin e fshatarëve të fshatit Debëllde, përkatësisht pronave të tyre private. Kjo ndarje e mjeteve financiare u bë si rezultat i arritjes së marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, ashtu edhe siç parashihet me pakon e Ahtisaarit për konkludimin e marrëveshjes së demarkacionit të kufirit në mes të dy vendeve.

Në vitin 2001 si rezultat e arritjes së marrëveshjes në mes të Republikës së Serbisë dhe asaj të Maqedonisë, Kosovës iu aneksuan gjithsejtë 2500 ha territor dhe iu dhanë Republikës së Maqedonisë. Që nga ajo kohë e deri më 2009, banorët e fshatit Debëllde, të Komunës së Vitisë, si rezultat i kësaj marrëveshjeje, iu kishte humbur e drejta për shfrytëzimin e tokave të tyre.

Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, të datës 11 qershor 2010, ekspertët e kishin bërë një vlerësim të dëmeve nga mungesa e shfrytëzimit të tokave të tyre dhe si rezultat kishin konstatuar që Qeveria e Kosovës duhet t'i kompensojë këta pronarë me një shumë prej 530.000 euro. Me këtë vendim, ishin ndarë vetëm 200 mijë euro duke lënë mundësinë për alokimin e pjesës së mbetur prej 330 mijë euro për më vonë, përkatësisht deri më 1 qershor të këtij viti kur edhe u vendos t'i ndahet kjo pjesë e mbetur këtyre pronarëve.

Ndërkaq një vendim i po kësaj natyre është marrë në po të njëjtën mbledhje për kompensimin e banorëve të

Junikut, Klinës, Drenasit, Deçanit dhe Vitisë, lidhur me pasojat e fatkeqësisë natyrore në fund të vitit të kaluar, meqë rast pronat bujqësore pësuan dëmtime si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut. Me këtë vendim 09/17, u ndryshua Vendimi 02/150 për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 500.000 euro. Nga kjo shumë, komunat që do të përfitojnë janë:

- Komuna e Junikut – 60,000 euro;
- Komuna e Klinës – 28,800 euro;
- Komuna e Drenasit – 45,000 euro;
- Komuna e Deçanit – 354,700 euro;
- Komuna e Vitisë – 11,500 euro.

Gjithashtu, 200.000 euro ndahen për Komunën e Prishtinës për të njëjtën arsye të mbulimit të humbjeve materiale nga vërshimet në muajin maj të këtij viti. Po ashtu, 480,000 euro ndahen për Komunën e Gjilanit për vazhdimin e rregullimit të shtratit të lumit të qytetit.

Ndërsa, në mbledhjen pasuese, pra të 18-të, Qeveria morri dy vendime për alokim të mjeteve financiare në shumë prej 199,800 euro me qëllim mbulimin e shpenzimeve për rehabilitimin e 900 Invalidëve të luftës të UÇK-së, përkatësisht 120,000 euro për familjet e dëshmorëve, në bregdetin shqiptar. Ky është viti i katërt i ndarjes së mjeteve financiare për këtë kategori. Nga viti 2008, e deri më tani, duke përfshirë edhe vendimin e fundit, Qeveria e Kosovës ka ndarë gjithsejtë 922,800 euro për qëllim të mbulimit të shpenzimeve në bregdetin shqiptarë.

Në mbledhjen e 18 u vendos edhe për ndarjen e një shume tjetër financiare prej 46,000 euro për mbulimin e

shpenzimeve për bashkë-organizim dhe mbajtjen e Konferencës për Kosovën në Forumin Ekonomik të Vjenës. Kosova është anëtare e Forumit Ekonomik të Vjenë, organizatë kjo jo-formale e formuar në prill të 2004 dhe qëllimi i themelimit të kësaj organizate ishte promovimi i bashkëpunimit ekonomik në mes të shteteve nga Adriatiku deri në Detin e Zi. President i kësaj organizate është Z. Erhard Busek. Ky forum ka pasur rastin të organizojë një mbledhje të saj në Prishtinë në fund të marsit 2009, me temën "Investimet në Kosovë".

Gjithashtu, në mbledhjen e 19-të, të mbajtur më 15 qershor Qeveria mori vendim, që Ministria e Financave të krijojë një linjë të re buxhetore në tabelat e buxhetit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 për Ministrinë e Diasporës, e themeluar me 18 maj me Vendimin 09/15 dhe ndau mjete financiare në vlerë prej 750,000 euro prej të cilave:

- 270,000 euro për Mallra dhe Shërbime;
- 180,000 euro për paga, dhe;
- 300,000 për shpenzime kapitale.

Me vendimin e fundit, shuma e mjeteve financiare të ndara për këto qëllime të paraqitura më lartë arrin në shifrën prej 2,6 milion euro vetëm për muajin qershor, shumë e cila nuk përputhet me vlerën e përcaktuar në tabelat buxhetore – kategoria buxhetore – Rezervat e paparashikuara të Ligjit për Buxhetin 2011 të miratuar nga Kuvendi me 1 prill, e cila është 2,5 milion euro, por që është vlerë e cila duhet ta mbulojë tërë vitin fiskal.

Miratohet Rregullorja për pushimet e shërbyesve civil

• Me rregulloren e re nëpunësja civile gëzon të drejtën e pushimit të lehonisë prej 12 muajsh. Përderisa të gjithë punonjëset në sektorin privat dhe në atë publik gëzojnë këtë të drejtë që nga viti i kaluar, për nëpunësen civile deri në qershor 2011 është aplikuar pushimi i lehonisë me sistem 3+3.

Me vendimin Nr. 05/19, Qeveria e Kosovës ka miratuar Rregulloren Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil. Kjo rregullore, e miratuar në mbledhjen e 15 qershorit, shfuqizon udhëzimin administrativ Nr. MSHP/DASHC 10/2003 e cili deri tani ka rregulluar strukturën e pushimeve të nëpunësve civil. Nëpunësit civil e kishin pushimin të rregulluar më ndryshe nga se e parasheh Ligji i Punës që është në fuqi që nga 16 dhjetori 2010. Një nga dallimet më të mëdha që njëherit shkaktoi edhe shumë zemërim dhe paqartësi tek kjo kategori ishte neni që rregullon pushimin e lehonisë. Përderisa Ligji i Punës garantonte pushimin e lehonisë me pagesë prej 6+3 muajsh, nëpunëset civile deri në miratimin e kësaj rregullore u takonte pushim i lehonisë me pagesë prej 3 muajsh, kjo pra sipas udhëzuesit administrativ nr. 10/2003. Por, sipas rregullores së re nëpunësja civile gëzon të drejtën e pushimit të lehonisë prej 12 muajsh, ku 6 muaj paguhet nga institucioni me kompensim prej 70% të pagës, 3 muajt në vijim paguhet nga Qeveria me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, dhe tre muajt e tjerë mund të merren pa pagesë.

Një sistem i tillë i pushimit të lehonisë parashihet edhe me Ligjin e Punës, i cili aplikohet për të punësuarit si në sektorin publik ashtu


edhe në atë privat. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale më 20 prill 2011 kishte nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2011 për Rregullimin dhe Përcaktimin e Procedurave Administrative të Pagesës Financiare për Pushim të Lehonisë, por ky dokument nuk ishte bërë publik deri në fillim të qershorit. Neni 12 i këtij Udhëzimi shfuqizon dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2007 për Rregullimin dhe Përcaktimin e Procedurave të Pagesës Financiare për Pushim të Lehonisë në Shërbimin Civil të Kosovës. Kjo do të thotë se me U.A. Nr. 05/2011 lehonat në shërbimin civil është dashur të kenë pushimin e lehonisë sipas sistemit 6+3+3. Megjithatë, ende mbetet e pa qartë përse ky U.A. nuk është publikuar në prill por vetëm në qershor 2011, dhe çfarë ka ndodhur me nëpunëset civile që iu është dhënë pushimi i lehonisë me sistem të vjetër gjatë kësaj periudhe (prill – qershor)?

Sidoqoftë, Rregullorja nr. 06/2011 vetëm se e fuqizon të drejtën e nëpunësve civile për pushim të lehonisë prej 12 muajsh. Në shërbimin civil të Kosovës llogaritet se janë të punësuar rreth 24,000 punonjës kurse deri në muajin qershor gjithsej 226 nëpunëse civile ndodheshin në pushim të lehonisë. Pushimi i lehonisë për shërbyesit civil për nëntë muaj të tërë duhet të mbulohet nga buxheti i Kosovës.

Varësisht prej nivelit të pozitës, nëpunësit civil e kanë të përcaktuar edhe nivelin e pagës. Por nëse merret paga mesatare aktuale në Kosovë prej 345 euro, atëherë pushimi i lehonisë për një person do t'i kushtonte buxhetit të Kosovës 1,966 euro (70% e pagës mesatare për 6 muaj llogaritet të jetë 1,449 euro, plus 50% e pagës mesatare për 3 muajt tjerë është 517.5 euro). Këtu vjen në shprehje buxheti i ndarë nga Qeveria për pushim të lehonisë prej 300,000 euro, që assesi nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar koston e pushimit të lehonisë në sektorin publik, pa harruar edhe 3 mujorin në sektorin privat. (Më shumë rreth vështirësive në zbatimin e Ligjit të Punës mund të lexoni në analizën e Institutit GAP 'Ligji i Punës gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi', qershor 2011.)

Dispozitat tjera të Rregullores nr. 06/2011 rregullojnë pushimet tjera të nëpunësve civil sikurse: e drejta për pushim vjetor prej 18 ditë pune kur për çdo dy vjet të punës së kaluar në shërbimin civil i shtohet pushimi vjetor nga një ditë; pushimi në ditët e festave zyrtare; pushimi mjekësor me pagesë deri në 20 ditë pune në vit; pushimi me rastin e martesës; pushimi në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes; pushimet tjera pa pagesë, etj.

Rregullimi i marrëdhënies së
punës në Kosovë





Rikonfigurohet Komitetit Drejtues i Projektit për Asistencë Teknike Energjia nga Linjiti

Në mbledhjen e 17-të, të mbajtur më 1 Qershor 2011, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për rikonfigurimin e Komitetit Drejtues të Projektit për Asistencë Teknike Energjia nga Linjiti, komitet ky përgjegjës për projektin Termocentrali Kosova e Re, të themeluar me vendimin Nr. 2006/6.

Përbërja e re e Komitetit do të jetë si në vijim:

- Ministri i Zhvillimit Ekonomik (kryesues)
- Ministri i Financave (anëtar)
- Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (anëtar)
- Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (anëtar)
- Kryesuesi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (anëtar)
- Kryesuesi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (anëtar) dhe
- Një përfaqësues i emëruar nga Zyra e Kryeministrit (anëtar)

Projekti i Termocentralit Kosova e Re vlerësohet materialisht i avancuar dhe si rrjedhojë është i përjashtuar nga autorizimet paraprake dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin mbi Partneritetet Publiko-Private dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe Procedurat për dhënien e tyre. Megjithatë, Qeveria konfirmon se procesi i prokurimit do të shfrytëzojë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese për dhënien e kontratave një ofruesi për projek-

tin Termocentrali Kosova e Re

Ndërkaq, në mbledhjen e saj të 18-të, të mbajtur më 8 Qershor 2011, Qeveria e Kosovës ka miratuar shqyrtimin e propozim-vendimit për themelimin e Komisionit Ndërmarrjet Publike, i cili komision do të përbëhet nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Ministri i Infrastrukturës, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministri i Financave dhe Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ky komision është themeluar në bazë të Ligjit për Partneritetin Publiko-Privat dhe ka funksionuar edhe më parë, por për shkak të zhvillimeve që kanë ndodhur pas legjislavit të fundit dhe aprovimit të rregullores 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive është parë i domosdoshëm miratimi i këtij propozim-vendimi. Ky propozim-vendim konfirmon se komisioni i Ministrave është i njëjtë siç parashihet në ligjin për ndërmarrjet publike dhe se komisioni i Ministrave mundëson funksionalizimin e këtij komisioni ndërmarrjet.

Komision Ndërmarrjet Publike-Private, i menaxhon politikat e zhvillimit të partneriteteve publiko-private dhe bën shqyrtimin, miratimin ose

refuzimin e projekt-propozimeve. Në mbledhjen e 83-të të Qeverisë, të mbajtur në Shtator të vitit 2009, Qeveria kishte miratuar vendimin e Zyrës së Kryeministrit që ta emërojë Bekim Çollakun si përfaqësues nga kjo zyrë në Komisionin Ndërmarrjet Publike (shih: <http://www.gapmonitor.org/index.php?id=2&n=203>).

Ligji për ndërmarrjet publike ka për qëllim t'i përcaktojë kushtet me të cilat palët private mund të marrin koncesione, ose ndonjë mënyrë tjetër për shfrytëzimin ose eksploatimin e infrastrukturës publike, ndërmarrjeve publike dhe burimeve publike.

Po ashtu në mbledhjen e 20 të mbajtur më 22 qershor 2011, Qeveria mori vendimin për themelimin e Grupit punues Ndërmarrjet Publike për Reformën e Ambientit të Biznesit. Qëllimi i themelimit të këtij grupi punues është të bëjë monitorimin e zbatimit të reformës së të bërit biznes duke identifikuar pengesat dhe ngarkesat e panevojshme për biznese, duke ekzaminuar politikat, proceset dhe inspeksionet qeveritare, vendosjen e prioritetëve afat shkurtra, afatmesme dhe afatgjate. Po ashtu ky grup punues do t'i propozojë rekomandimet specifike për ndryshime ligjore dhe të politikave. Grupi punues do t'i raportojë Kryeministrit dhe ministrave në baza mujore.

Vendimet tjera

• *Edhe në vendimin e vitit të kaluar por edhe në këtë vendim të fundit nuk është cekur fare marrësi i këtyre mjeteve, por vetëm xhirollogaria se ku janë derdhur në numër 21-12-0000131438-78 në Bankën Komerciale TEB.*

Raportet për të gjitha vendimet e marra nga Qeveria e Kosovës gjatë muajit qershor 2011 janë publikuar në portalin e GAP Monitor në internet www.gapmonitor.org. Disa nga vendimet tjera të marra këtë muaj janë:

- **Ndërtimi i autostradës Prishtinë – Hani i Elezit të fillojë brenda vitit 2012.** Qeveria e Kosovës në mbledhjen e 20 - të radhës mori vendim për ndërtimin e autostradës Prishtinë – Hani i Elezit. [Raporti i plotë në <http://www.gapmonitor.org/index.php?id=2&n=395>].

- **Aprovohet Ndryshimi dhe Plotësimi i Vendimit të Qeverisë për Pajisje me Pasaporta Diplomatie.** Në mbledhjen e 17-të të Qeverisë së Kosovës të mbajtur më 1 Qershor 2011, për të tretën herë u plotësua ligji mbi Dokumentet e Udhëtimit. [Raporti i plotë në <http://www.gapmonitor.org/index.php?id=2&n=394>].

- **Miratohet Rregullorja për Gradimin dhe Pagesat e Kryesve dhe Performuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore.** Në mbledhjen e 17-të të Qeverisë, të mbajtur më 1 Qershor 2011, është

miratuar Rregullorja nr. 05/2011 për Gradimin dhe Pagesat e Kryesve dhe Performuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore. [Raporti i plotë në <http://www.gapmonitor.org/index.php?id=2&n=393>].

- **Përcaktohet përbërja e Këshillit të Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë.** Në mbledhjen e 19-të të vendimin 10/19, Qeveria mori vendim që Këshilli i Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë të përbëhet prej Kryetarit të Këshillit dhe ketë 7 anëtarëve të rregullt. [Raporti i plotë në <http://www.gapmonitor.org/index.php?id=2&n=392>].

- **Themelohet Komisioni Kombëtar për Sigurimin e Aviacionit Civil.** Komisioni do të kryesohet nga Ministri i Punëve të Brendshme, ashtu edhe siç parashihet me nenin 89 të Ligjit për Aviacionin Civil. [Raporti i plotë në <http://www.gapmonitor.org/index.php?id=2&n=391>].

- **Konsolidohet Sektori i Shërbimeve të Ujit.** Në mbledhjen e 18-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 8 Qershor, 2011, u

miratua vendimi për konsolidimin e Sektorit të Shërbimeve të Ujit. [Raporti i plotë në <http://www.gapmonitor.org/index.php?id=2&n=390>].

- **Miratohet vendimi për Implementimin e Ligjit për ish të Dënuarit dhe Përndjekurit Politikë.** Në mbledhjen e 18-të, të mbajtur më 8 Qershor 2011, Qeveria e Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Financave, ka miratuar propozim-vendimin për implementimin e ligjit 03/L-95 për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe Përndjekurve Politikë. [Raporti i plotë në <http://www.gapmonitor.org/index.php?id=2&n=388>].

- **Autorizohet Agjencia e Produkteve Medicinale që të Lëshoj Licencë Importi.** Në mbledhjen e saj të 19-të, të mbajtur më 15 Qershor 2011, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin nr. 11/19, i cili autorizon Agjencinë për Produkte Medicinale që të lëshojë licencë importi për sasi dhe lloje të caktuara të produkteve medicinale pa autorizim marketingu dedikuar tregut të vendit. [Raporti i plotë në <http://www.gapmonitor.org/index.php?id=2&n=387>].

Përmbledhje

Të gjitha vendimet e marra gjatë muajit qershor:

1. Vendimet nga mbledhja e 17 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 1 qershor 2011

- 1.1. Vendimi 01/17, miratohet Projektligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera;
- 1.2. Vendimi 02/17, miratohet Projektligji për markat tregtare;
- 1.3. Vendimi 03/17, miratohet Projektligji për Dizajnin Industrial;
- 1.4. Vendimi 04/17, miratohet Projektligji për Patenta;
- 1.5. Vendimi 05/17, miratohet Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. 02/31 për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe zyrtare;
- 1.6. Vendimi 06/17, ndahen 330,000 euro për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga mosshfrytëzimi i tokave në pajtim me vendimin Nr 11/128;
- 1.7. Vendimi 07/17, aprovohet rregullorja për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore;
- 1.8. Vendimi 08/17, Komiteti Drejtues i Projektit të Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti rikonfigurohet;
- 1.9. Vendimi 09/17, Ndryshohet dhe plotësohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 500.000 euro për përmbytjen në Komunitet e Kosovës (Junik, Klinë, Drenas, Deçan dhe Viti);

2. Vendimet nga mbledhja e 18 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 8 qershor 2011

- 2.1. Vendimi 02/18, Miratohet me ndryshime Projektligji për Arsimin Para-universitar;
- 2.2. Vendimi 03/18, Miratohet Projektligji për përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale;
- 2.3. Vendimi 04/18, Miratohet Projektligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale;
- 2.4. Vendimi 05/18, themelohet Komisioni i Ministrave me qëllim të përgatitjes së debatit në Qeveri për çështjet që kanë të bëjnë me Ndërmarrjet Publike;
- 2.5. Vendimi 06/18, Qeveria do të vazhdojë të mbështesë korporatizimin e shtatë kompanive rajonale të ujësjellësve;
- 2.6. Vendimi 07/18, Ndahen mjete financiare në vlerë prej 199.800 euro me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për rehabilitimin e 900 Invalidëve të luftës së UCK-së në bregdetin shqiptar;
- 2.7. Vendimi 08/18, Ndahen mjete financiare në vlerë prej 120.000 euro për mbulimin e shpenzimeve për rehabilitimin e 600 Familjeve të Dëshmorëve të UCK-së në bregdetin e Durrësit;
- 2.8. Vendimi 09/18, ndahen mjete financiare në vlerë prej 46,000 euro për mbulimit të shpenzimeve për bashkë-organizim dhe mbajtjen e Konferencës për Kosovën në Forumin Ekonomik të Vjenës;
- 2.9. Vendimi 10/18, Z. Nazmi Zenelaj emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik;
- 2.10. Vendimi 11/11, Z. Xhavit Dakaj emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- 2.11. Vendimi 12/18, Miratohet Strategjia për Arritjen e Njohjes së Plotë Ndërkombëtare të republikës së Kosovës;
- 2.12. Vendimi 13/18, Miratohet kërkesa e MF për zbatimin e Ligjit nr.03/L-95 për të drejtat e ish personave të dënuar dhe të persekutuar politikisht.

3. Vendimet nga mbledhja e 19 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 15 qershor 2011

- 3.1. Vendimi 02/19, Miratohet Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- 3.2. Vendimi 03/19, Miratohet Projektligji për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre;
- 3.3. Vendimi 04/Miratohet Projektligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- 3.4. Vendimi 05/19, Miratohet Rregullorja për Pushimet e Nëpunësve Civil;
- 3.5. Vendimi 06/19, Ndahen mjete financiare në vlerë prej 150,000 euro për mbulim të shpenzimeve për rehabilitimin e 750 Veteranëve të luftës së UCK-së;
- 3.6. Vendimi 07/19, Miratohet Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr.02/2011, për fushat e përgjegjësisë administrative të ZKM-së dhe ministrive;
- 3.7. Vendimi 08/19, Themelohet komisioni Kombëtar për Sigurimin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës;
- 3.8. Vendimi 09/19, Të shpallet zonë nën mbrojtje dhe interes të veçantë ku është zhvilluar "Beteja e Ko-shares" brigada Agim Ramadani me sipërfaqe prej 2488 ha në Komunën e Gjakovës;

- 3.9. Vendimi 10/19, Themelohet Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë;
- 3.10. Vendimi 11/19, Autorizohet Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale që të lëshoj licencë importi për një sasi dhe lloj të caktuar të produkteve medicinale pa autorizim të marketingut;
- 3.11. Vendimi 12/19, Ministria e Financave të krijoj një linë të re buxhetore në tabelat e buxhetit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 për Ministrinë e Diasporës.

4. Vendimet nga mbledhja e 20 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 22 qershor 2011

- 4.1. Vendimi 02/20, Obligohet Ministria e Infrastrukturës të zhvilloj të gjitha procedurat e tenderimit për zbatimin e projektit të ndërtimit të autostradës R6, Prishtinë – Hani i Elezit sipas një modeli tradicional kontrate, në pajtim me Ligjin e prokurimit Publik;
- 4.2. Vendimi 03/20, Miratohet Projektligjin për Arsimin e Lartë
- 4.3. Vendimi 04/20, Miratohet Projektligjin për Statistikat Zyrtare të Republikë së Kosovës.
- 4.4. Vendimi 05/20, Aprovohet kërkesa e MF për shtimin e listës të Aneksit A të Ligjit nr.03/L-220 për aplikimin e Normës së Tatimit të Akcizës në Vetura;
- 4.5. Vendimi 06/20, për ndalimin e importit për lëshim në qarkullim të lirë dhe për lëshimin në qarkullim të lirë nga çdo depo doganore, të çfarëdo automjeti motorik të regjistruar për herë të parë brenda ose jashtë Kosovës para 13 ose më shumë vitesh;
- 4.6. Vendimi 07/20, aprovohet Plani Hapësinor me interes të veçantë Ekonomik “Fusha e Mihjes së Re 2010-2020”,
- 4.7. Vendimi 08/20, themelohet e Grupit punues Ndërmintor për Reformën e Ambientit të Biznesit;
- 4.8. Vendimi 09/20, z. Naim Baftiu emërohet Sekretar i Ministrinë e Financave;
- 4.9. Vendimi 10/20, z. Shkëlzen Syla emërohet Sekretari Përgjithshëm në Ministrinë e Forcës së Sigurisë;
- 4.10. Vendimi 11/20, znj. Eljana Caka emërohet Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;
- 4.11. Vendimi 12/20, miratohet Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Zyrave Komunale për Integritet Evropiane .

5. Vendimet nga mbledhja e 21 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 29 qershor 2011

- 5.1 Vendimi 02/21, miratohet Projektligji për Prokurimin Publik;
- 5.2 Vendimi 03/21, miratohet Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave;
- 5.3 Vendimi 04/21, miratohet Projektligji për Transmetuesin Publik të Kosovës;
- 5.4 Vendimi 05/21, miratohet Projektligji për Përfitimin e ish Zyrtarëve të lartë;
- 5.5 Vendimi 06/21, miratohet Projektligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësime të Konformitetit;
- 5.6 Vendimi 07/21, miratohet Projektligji për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit;
- 5.7 Vendimi 08/21, miratohet Projektligji për Rregullimin e Tokës;
- 5.8 Vendimi 09/21, miratohet Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010 -2010;
- 5.9 Vendimi 10/21, miratohet propozim – vendimi për propozimin e Kryetarit dhe anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave;
- 5.10 Vendimi 11/21, miratohet Dokumenti Strategjik për Konservim të Integruar në Kosovë.

gap monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

Rr. Nëna Terezë 41/29
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 38 224 145
monitor@insitutigap.org
www.institutigap.org

"GAP Monitor" është projekt i Institutit për Studime të Avancuara GAP në të cilin monitorohen vendimet e Qeverisë së Kosovës. Projekti i "GAP Monitor" ka filluar në janar të 2009, ku përmes publikimeve të përmuajshme Instituti GAP i ofron publikut informata dhe analiza më të thella për të gjitha vendimet e Qeverisë së Kosovës. Tani, projektit të "GAP Monitor" është shtuar edhe faqja e re në internet, e cila na mundëson interaktivitet më të madh me lexuesit si dhe mundësinë për të publikuar lajme dhe analiza në kohë më të shpejtë.


INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Të gjitha raportet për vendimet e Qeverisë mund të gjenden edhe në portalin e GAP Monitor në internet
www.gapmonitor.org

Instituti për Studime të Avancuara GAP
përkrahet nga:



Projekti i GAP Monitor
përkrahet nga:

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të Institutit GAP dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e donatorëve të këtij projekti.